ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Oper. Sistemi,Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KOSTT-26-8613-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Nënstacion Mobil 110 10(20) kV me Transformator Fuqie 31.5 MVA**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Kosmati SH.P.K.**
NUI	**812269729**
Adresa	**Rr. Sokol Sopi, Nr.364**
Vendi	**Prishtine**
Kodi postar	**10 000**
Numri Telefonit	**049111833**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Naser Gashi**
Adresa elektronike	**info@kosmati.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**05.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me Nënstacion Mobil 110 10(20) kV me Transformator Fuqie 31.5 MVA

- **Lloji i kontratës_1 Furnizim**
- **Lloji i procedurës_1 Procedurë e hapur**
- **Vlera e parashikuar_8,020,000.00 €**
- **Afati për dorëzim e ofertave_30.10.2026;**
- **Data e njoftimit_08.10.2026**
- **Ligji: LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**
- **Dergimi i kerkeses per Rishqyrtim_23.10.2026**
- **Pergjigje ne kerkesen per Rishqyrtim_26.10.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Në datën 23 tetor 2026, kemi inicuar procedurën për rishqyrtim ndaj Autoritetit Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.. Me 26 tetor 2026 kemi pranuar përgjigjen zyrtare, përkatësisht vendimin e Autoritetit Kontraktues në

lidhje me kërkesën tonë për Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

- Neni 27 - Dosja e Tenderit

- Neni 51 - Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

- Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në cilësinë e palës së interesuar në aktivitetin e prokurimit të iniciuar nga KOSTT SH.A., paraqesim ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, duke kontestuar kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit te projektit ne fjale te cilat ne formen e tanishme jane diskriminuese dhe pamundesojne konkurrencen. Ne te njejten kohe kundershtojme vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim per pretendimet ankimore te lartecekura.

PRETENDIMI ANKIMOR

Kriteri i përvojës së prodhuesit – referenca per 20 nënstacione mobile brenda tri viteve

Në pikat 9.1 dhe 9.2 të Fletës së të Dhënave të Tenderit, KOSTT SH.A. ka kërkuar që

prodhuesi i nënstacionit mobil, **i cili autorizon operatorin ekonomik për ofertim**, të dëshmojë se gjatë tri viteve të fundit **ka furnizuar dhe liferuar së paku 20 nënstacione mobile** të nivelit të tensionit 110 kV ose më lart.

Kjo kërkesë paraqet një prag jashtëzakonisht të lartë të përvojës paraprake, i cili nuk është arsyetuar në raport me objektin konkret të kontratës, që ka të bëjë me furnizimin e një nënstacioni mobil.

Sipas neneve 51.3 dhe 69.1, 69.2.1 dhe 69.3 të LPP-së, kërkesat për kapacitet teknik dhe profesional duhet të jenë relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Pretendimi i KOSTT-it se tregu ndërkombëtar përmban prodhues serikë dhe se njëzet njësi janë të arritshme për një kontratë mbi 8 milionë euro nuk korespondon me gjendjen reale ne treg sepse konform komunkimeve me prodhus global te gatshem per te marre pjese ne kete Aktivitet te Prokurimit, jemi informuar se nje kriter i tille nuk mund te permbushet nga ana e tyre ne 3 vitet e fundit.

Gjithashtu, fakti se kriteri i drejtohet prodhuesit citat **"i cili autorizon operatorin ekonomik për ofertim"** nuk e eliminon efektin kufizues në konkurrencë, ne te njejten kohe eshte deshmi e favorizimit te nje prodhuesi dhe nje operator ekonomik dhe pasi operatorët që bashkëpunojnë me prodhues të rangut boteror por që nuk i plotësojnë njëzet (20) referencat, përjashtohen praktikisht nga mundësia e ofertimit.

Kapaciteti teknik mund të verifikohet në mënyrë më të drejtpërdrejtë përmes referencave të projekteve të ngjashme, certifikatave të pranimit, raporteve të testeve FAT dhe SAT, dokumentacionit të sigurimit të cilësisë, dëshmive për kapacitetet prodhuese dhe personelin e specializuar, si dhe inspektimit të fabrikës mirepo kerkesa per 20 cope eshte diksriminim i hapur.

Për rrjedhojë, kërkojmë që kriteri të ndryshohet dhe të lejohet dëshmimi i përvojës përmes së paku dy projekteve të realizuara me sukses në projektimin, prodhimin dhe liferimin e nënstacioneve mobile 110 kV ose më lart, të mbështetura me certifikata pranimi, referenca të klientëve apo dokumentacion teknik përkatës.

Vendimi i AK për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk përmban analizë të plotë dhe individuale të pretendimeve të paraqitura. Referimi i përgjithshëm në nenin 69 të LPP-së nuk përbën arsyetim të mjaftueshëm për ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e secilit kriter.

Po ashtu, pretendimi se çdo operator mund të ofertojë përmes autorizimit të një prodhuesi të kualifikuar nuk e adreson efektin kufizues të kriterit, pasi kufizimi i numrit të prodhuesve që mund të autorizojnë operatorët ndikon drejtpërdrejt në konkurrencën reale.

Për këto arsye, kërkojmë që OSHP të shqyrtojë jo vetëm përmbajtjen e Dosjes së Tenderit, por edhe mjaftueshmërinë e arsyetimit të vendimit të KOSTT-it për refuzimin e rishqyrtimit, duke vlerësuar nëse pretendimet janë trajtuar në përputhje me kërkesat ligjore për vendimmarrje të argumentuar.

Neni 7 i LPP-së ndalon jo vetëm diskriminimin e drejtpërdrejtë, por edhe përcaktimin e kërkesave që në mënyrë të pajustifikuar reduktojnë ose eliminojnë konkurrencën. Për këtë

arsye, vlerësimi i ligjshmërisë duhet të përfshijë edhe ndikimin e përgjithshëm të kushteve të vendosura në mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë të kualifikuar.

Rrjedhimisht, mbeshtetur ne faktet e paraqitura dhe dispozitat përkatëse të LPP-së, i propozojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që ta aprovojë si të bazuar ankesën tone dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues KOSTT-in të permiresoje kriterin diskriminues te numri te referencave te kerkuara te prodhuesit (Në pikat 9.1 dhe 9.2 të Fletës së të Dhënave të Tenderit), duke zvogeluara numrin e tyre brenda tri viteve me numer te arsyshem dhe te justifikuar nga tregu.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Aktualisht, nuk disponohet një vlerësim i saktësuar lidhur me përmasat e dëmeve materiale

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*